



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:029985

Datë: 20.09.2018

Numri i dokumentit: 00152660

P.nr.370/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Diana Sina, me procesmbajtësen Lamije Kuqi, – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve I.V. nga Gj., për shkak të veprës penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK, dhe veprës penale blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, kundër të akuzuarit S.M. nga Gj., për shkak të veprës penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si dhe kundër të akuzuarit J.Ma. nga Gj., për shkak të veprës penale blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.857/2015, të datës 01.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë **20.09.2018**, në prezencën e Prokurori i shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarve, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari **I.V.** nga i ati S. dhe e ëma A. e gjinisë A., data e lindjes... në Gj., ku dhe tani banon, në rrugën A.I. pn.-K., analfabet, i martuar-atë i 2 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, ashkali, shtetas i R Kosovës.

2.I akuzuari **S.M.**, nga i ati M.dhe e ëma H. e gjinisë L. data e lindjes ... në Gjakovë, ku dhe tani banon, në rrugën A.I. pn.-K., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-atë i 1 fëmije, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, ashkali, shtetas i R Kosovës.

3. I akuzuari **J. M.**, nga i ati S. dhe e ëma Sh. e gjinisë G.. data e lindjes ... në Gjakovë, ku dhe tani banon, në rrugën A.I. pn.-K., analfabet, i martuar-atë i 3 fëmije, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, egjiptian, shtetas i R Kosovës.

I akuzuari I.V.:

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

I. Me datën 28.05.2015 rreth orës 20.45 minuta, në Gj., me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për vete apo tjetrin e me qëllim vjedhje, shkon te ish objekti i fabrikës së “V.” përkatësisht te depoja e marrur me qera nga i dëmtuari Q.B. nga Gjakova, Rr.”F.A.” nr...., dhe vjedh kablo elektrike të makinës që bën thyerjen e këndeve si dhe një karroc dore, e të gjitha këto në vlerë prej 3.800 euro, e largohet në drejtim të pa ditur.

Me datën 02.07.2015 rreth orës 10.28 minuta, në Gj., me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për vete apo tjetrin e me qëllim vjedhje, shkon te ish objekti i fabrikës së 2...” përkatësisht te trafoja jo funksionale dhe i hap dyert e trafos, e brenda i dëmton dy trafo dhe vjedh gjashtë shina bakri, e të dëmtuarës K....-Distrikti Gj. i shkakton dëm në vlerë prej 6.000 euro, e largohet nga vendi i ngjarjes.

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 pika 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

II. Me dt.06.07.2015 rreth orës 22.00 minuta në Gj., duke ditur apo dashur të dijë se sendi është përfituar me veprën penale të vjedhjes, nga i pandehuri S.M. nga Gj., ka blerë një biçikletë për 10 euro, pronë e të dëmtuarit F. B. Z.nga Gj. , e biçikleta i është sekuestruar te i akuzuari I.V., dhe e dëmtuar i është kthyer pronarit-të dëmtuarit.

-me çka ka kryer veprën penale, blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari S.M.

Ë s h t ë f a j t o r

III. Me datën 27.06.2015 rreth orës 08.00 minuta, në Gjakovë, Rr.”F.B.”, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për vete apo tjetrin e me qëllim vjedhje, shkon te restoranti “M.”, afër Kuvendit Komunal Gjakovë, e kur e sheh të mbështetur për muri biçikletën, pronë e të dëmtuarit B.A.L. nga Gjakova, Rr.”H. D.” nr.... e vjedh, e largohet nga vendi i ngjarjes, ndërsa biçikletën në Stacionin e autobusëve e shet për 10 euro personit të panjohur.

Me datën 06.07.2015, rreth orës 20.00 min. në Gj., “H.D.” afër “N.”, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për vete apo tjetrin e me qëllim vjedhje, të dëmtuarit F.B.Z.a nga Gjakova, “A.L. –O.” P..., i cili me biçiklet kishte shkuar te një mik i tij, të parkuar në korridor të banesës i vjedh biçikletën, me ngjyrë të përizer kuq e kumri në vlerë prej 100 euro, e me biçikletë largohet në drejtim të pa ditur, e pas veprimeve hetimore policore biçikleta gjendet te i akuzuari J. M., e i sekuestrohet, e i kthehet e dëmtuar të dëmtuarit.

- me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 pika 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

I akuzuari J.M.

Ë s h t ë f a j t o r:

IV. Me datën 07.07.2015 rreth orës 21.00 minuta, në Gj. , duke ditur apo dashur të dij se sendi është përfituar me veprën penale të vjedhjes, nga i akuzuari I.V. nga Gj.ka blerë

një biçikletë për 20 euro, e pronë e të dëmtuarit F.B.Z. nga Gj., e biçikleta i është sekuestruar dhe e dëmtuar i është kthyer pronarit- të dëmtuarit.

-me çka ka kryer veprën penale, blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17.par.1,41,46,49,50,51,52,73 të KPRK-ës, dhe nenit 325 par.1 lidhur me nenin 81 dhe neni 345 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës,

Të akuzuarit I.V.:

I SHQIPTON

-Për veprën penale, të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 352 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, të përshkruar në pikën I-rë të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burg prej **6(gjashtë)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shumën prej **300.-(Treqind).-€**,

-Për veprën penale, blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së. të përshkruar në pikën II-të të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burg prej **4(katër)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

-Për dy vepra penale, për të cilat është shpallur fajtor, në kuptim të nenit 80 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, i shqipton **dënim unik** dënim me burg prej **8(tetë)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shumë prej **300.-(treqindë) Euro**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë.

Nëse përsioni i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15 (pesëmëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00€, (njëzet) euro** të gjobës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate

Të dëmtuarit: Q.(E.)B. nga Gj. rruga "F.A."nr ... „përfaqësuesi i fabrikës”V.” dhe F.(B.)Z. nga Gj. rr.”A.L.”pn.,kompensimin e dëmit mund ta realizojnë në kontest civil.

Gjykata në bazë të nenit 4,17.par.1,41, 46,49,50,51,52,73 të KPRK-ës, dhe nenit 325 par.1 lidhur me nenin 81, si dhe nenit 365 të KPPK-ës,

Të akuzuarit S.M.:

I SHQIPTON

-Për veprën penale, të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 352 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, të përshkruar në pikën III-të të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burg prej

6(gjashtë)muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shumën prej **300.-(Treqind).-€**,

Nëse përsone i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15 (pesëmëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00€, (njëzet) euro** të gjobës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate

Të dëmtuarit: Q.(E.)B. nga Gjakova rruga "F.A."nr .., B.(A.)L. nga Gjakova rr."H.D."nr...dhe F.(B.)Z. nga Gjakova rr. "A.L." pn.,kompensimin e dëmit mund ta realizojnë në kontest civil.

Gjykata në bazë të nenit 4,17.par.1,41,49,50,51,52,73 të KPRK-ës, dhe nenit 345 par.1, si dhe nenit 365 të KPPK-ës,

Të akuzuarit J.M.,,,,::

I SH Q I P T O N

-Për veprën penale, blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së të përshkruar në pikën IV-të të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burg prej **4(katër)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate

I dëmtuari: F,(B,)Z, nga Gjakova rr."A,L,"pn.,kompensimin e dëmit mund ta realizon në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.857/2015, të datës 01.06.2017, kundër të akuzuarve I,V, nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK, dhe veprës penale blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, kundër të akuzuarit S,M, nga Gj, , për shkak të veprës penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si dhe kundër të akuzuarit J,M, nga Gj,, për shkak të veprës penale blerje, pranim ose fshehje e sendeve të

përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, Prokurori i shtetit, në shqyrtimin gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve ,andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar të datës 14.08.2018 lidhur me fajësinë i akuzuari I,V, nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat akuzohet, ndërsa të akuzuarit S,M, dhe J, M, lidhur me fajësinë kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohen, Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi muar mendimin e prokurorit të çështjes, aprovoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve S,M, dhe J, M, me që veprimet e të akuzuarve në raport me të akuzuarin I,V, janë të ndara si dhe pranimi i fajësisë është bërë me vullnet pa presion duke ditur më parë për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë ,si dhe e njëjta mbështet në provat dhe faktet që përmban aktakuza.

I akuzuari **S.M.** në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale të përshkruara në dispozitivin e III dhe IV të aktakuzës, për veprën penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për të cilat vepra jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës që të njëjtat nuk do ti përsërisë, tani jam në vuajtje të dënimit për vepra të ngjashme penale dhe nga vuajtja e dënimit jam rehabilitu dhe premtoi se pas vuajtjes së dënimit do ti kthehem jetës normale, do të filloj të punoj dhe të kontribuoj në familje, shton se jam në gjendje tejet të vështirë materiale, jam baba i një fëmije, andaj i propozoj gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I akuzuari **J. M.** në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e VI të aktakuzës, për veprën penale pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, për të cilën vepër jam penduar pa masë dhe premtoi para gjykatës se të njëjtën nuk do ta përsërisë, si dhe biçikletën të cilën e kam blerë nga I.V. ia kam kthyer të dëmtuarit, shton se jam në gjendje të vështirë materiale, jam i pa punë, jam realizues i ndihmave sociale, jam mbajtës i tre fëmijëve, si dhe për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale, por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit.

Meqenëse të akuzuarit S.M. dhe J.M. kanë pranuar fajësinë gjykata konsideron se ndaj tyre nuk do të ketë procedurë të provave dhe as fjalë përfundimtare, po shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar vetëm ndaj të akuzuarit I.V. pasi i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat akuzohet.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.09.2018 i akuzuari I.V. pasi u njoftuar për të drejtat e tij,lidhur me fajësinë deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale blerje,pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, pranimin e fajësisë e bëj me vullnet të lirë dhe presion, duke ditur më parë për pasojat dhe favorin e pranimin të fajësisë, për të cilat vepra jam penduar pa masë dhe shprehi keq ardhje për dëmin e shkaktuar të dëmtuarëve.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit I.V., prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Pasi Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari I.V. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale, që i vihen në barrë dhe është i bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par. 4, të KPPK-ës, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve, pa administrimin e provave.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj në fjalën përfundimtare deklaron, gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e I,II dhe të V të aktakuzës lidhur me të akuzuarin I.V. për veprën penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, në këtë seancë gjyqësore u argumentuar me ligj me vetë faktin e pranimit të fajësisë së të akuzuarit I.V., i cili pa presion, me vullnet të lirë bëri një pranim të tillë, ku edhe nuk i mohoi veprimet e tija për veprat e cekura si në aktakuzë të cilat edhe e bëjnë përgjegjës si kryes i tyre, e po ashtu përgjegjësia penale i të njëjtit vërtetohet edhe me shkresat dhe provat si në aktakuzë, për çka kërkoi nga gjykata që i njëjti duhet të shpallet fajtor, të dënohet në bazë të ligjit si dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore, njehë rit krahas marrjes parasysh me rastin e marrjes së vendimit mbi shqiptimin e dënimit përveç rrethanave rënduese të merr edhe rrethanën lehtësuese, përkatësisht pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit në këtë shqyrtim gjyqësor.

I dëmtuari F.Z.në fjalën përfundimtare deklaron, se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensimin e dëmit.

I akuzuari I.V. në fjalën përfundimtare deklaron, se pendohem pa masë për veprat e kryera penale, tani jam në vuajtje të dënimit për veprat e kryera, por vuajtja e dënimit ka ndikuar mjaft në rehabilitimin tim dhe premtoi se pas vuajtjes së dënimit do ti kthehem jetës normale, do të filloi të punoi dhe të kontribuoi në familje, këto janë vepra të fundit që i kam kryer dhe tani nuk kam të iniciuar asnjë procedurë penale, shton se jam në gjendje tejet të dobët materiale, jam baba i dy fëmijëve të vegjël, të cilëve ju mungon kujdesi prindor, të cilët kryesisht janë varë nga puna që unë kam bërë si punëtor fizik herë pas herë, andaj lus gjykatën që ti ketë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Me faktet e ofruara, me provat që bashkëngjiten në shkresat e lëndës, e sidomos me pranimin e fajësisë nga i akuzuari I.V. është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin I-rë dhe të II-të, të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale të vjedhjes në vazhdimësi, nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe veprës penale blerje, pranim ose fshehje e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 345 par.1 të KPRK-së, për të cilat vepra i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve I.V., S. M. dhe J. M. , gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: gjendjen e varfër ekonomike të tyre, gjendjen familjare, janë baba të fëmijëve të vegjël, mbajtës të vetëm të familjes, punojnë si punëtor krahu, pranimin e fajit, pendimin e tyre të thellë për veprat e kryera, premtimin e të akuzuarve I.V. dhe S.M. se pas vuajtjes së dënimit do ti kthehen jetës normale, vuajtja e dënimit ka ndikuar pozitivisht në rehabilitimin e tyre, sjelljet korrekte të tyre gjatë gjykimit,

moshën e tyre të re në kohën e kryerjes së veprave penale, i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale nuk kërkon kompensimin e dëmit, në bazë të këtyre Gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, komfor nenit 75 par.1 nën par.1.2 të KPRK-ës, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata muarr se të njëjtit janë recidivista të këtyre veprave penale të kësaj natyre, tani i akuzuari I.V. dhe S.M. janë në vuajtje të dënimit me burgim afat gjatë për vepra të ngjashme penale, Gjykata konstaton se vuajtja e dënimit ka ndikuar në risocializimin e tyre edhe për kundër faktit se janë recidivista duke marr parasysh numrin e madh të lëndëve të grumbulluara në këtë Gjykatë, e sidomos duke marr parasysh vlerën e dëmit të shkaktuar me veprat penale të kryera, Gjykata të akuzuarit I.V. i shqiptoi dënim unik dënim me burg prej **8(tetë)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shumë prej **300.-(treqindë) Euro**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, të akuzuarit S.M. i shqiptoi dënim me kusht dënim me burg prej **6(gjashtë)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shumën prej **300.-(Treqind).-€**, të akuzuarit J.M. Gjykata i shqiptoi dënim me kusht, dënim me burg prej **4(katër)muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se këto dënime janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre, personalitetin e tyre, dhe se ky dënim i shqiptuar ndaj tyre do të arrij qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguajnë shpenzimet procedurale do ti rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarve dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.370/17, me datë 20.09.2018

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:029985
Datë: 20.09.2018
Numri i dokumentit: 00152660